



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna – Municipality Hani i Elezit



Nr. 02 / 9368 / 2023
Data: 01.11.2023

**Njoftim për organizimin e konsultimit publik me qytetarë për
Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Hanit të Elezit për
periudhën kohore 2024-2027**

Komuna e Hanit të Elezit përmes grupit punues, ka bërë hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Hanit të Elezit për periudhën kohore 2024-2027, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit, neni 79, si dhe Nenin 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, bën këtë njoftim:

Strategjia për Zhvillim Ekonomik është dokument i një rëndësie shumë të madhe ku në të prezantohen idetë, objektivat, vizioni dhe misioni i zhvillimit në vend për një periudhë të gjatë kohore.

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga **01.11.2023** deri më **01.12.2023**, ndërsa debati publik për qytetarë do të mbahet me datën **06.12.2023**, në Shtëpinë e Kulturës “Imri Curri”, duke filluar nga ora 14:00.

Komentet dhe sugjerimet tuaja mund t'i dërgoni deri më **01.12.2023** në orën 16:00, në e-mail adresën komunahaniielezit@gmail.com

Ju mirëpresim!



Qytetari i Komunës
Nehmet Ballazhi